



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:907082
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05411926

Rev.nr.84/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Nenad Llaziq dhe Mr.sc. Muhamet Rexha , anëtarë, në çështjen juridike të paditësit I. (S.) B. nga S. i përfaqësuar nga Zef Delhysa - avokat nga P., kundër të paditurve R. (R.) B., N. (R.) B., B. (Xh.) B., Xh. (F.) B. dhe A.(F.) B. që të gjithë nga S. të përfaqësuar nga Adem Jetishi avokat nga P., me objekt të çështjes juridike padi vërtetimi, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1841/2019, datë 23.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 04.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pathemeltë revizioni i paditësit i paraqitur përmes të autorizuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1841/2019, datë 23.11.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren –Dega në Suharekë,C.nr.209/18, të datës 27.12.2018 në pikëm I të dispozitivit aprovohet kërkesëpadia e paditësit I. (S.) B. nga S., si e bazuar. Në Pikën II Vërtetohet se paditësi I. (S.) B. ka qenë posedues faktik i ngastrës kadastrale në sipërfaqe prej 250 m2, në vendin e quajtur V.(V.) në S., e evidentuar në certifikatën e pronës me nr. të datës 26.10.2018. Në pikën III vërtetohet se ngastra kadastrale e përshkruar si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi është shpronësuar me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Kosovës

nr..... dt. 23.12.2010, për ndërtimin e autostradës Vermicë-Merdare, për të cilën të paditurit kanë marr shpërblimin nga shpronësimi në shumën prej 11,925.00 €, me çka janë pasuruar pa bazë. Në pikën IV detyrohen të paditurit që shumën e shpërblimit të fituar pa bazë nga shpronësimi në vlerë 11 925,00 €, t'ia paguajnë paditësit në mënyrë solidare me kamatë ligjore prej 7%, duke e llogaritur nga data 07.12.2011. Në pikën V obligohen të paditurit që paditësit t'ia paguajnë të gjitha shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme prej 2.507,20 €. Te gjitha këto të paditurit duhet që t'i paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi".

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr1841/2019, datë 23.11.2023 ishte aprovuar ankesa e të paditurave R. (R.) B., N. (R.) B., B. (Xh.) B., Xh. (F.) B. dhe A. (F.) B. që të gjithë nga S., dhe ishte vendosur që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega Suharekë C.nr.209/18 me datë 27.12.2018, ashtu që refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit I. B. nga S. me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar faktik i parcelës kadastrale numër P-....., me sipërfaqe prej 250 m2, në vendin e quajtur V./V. në S. si dhe të vërtetohet se ngastra kadastrale si më sipër është shpronësuar me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr....., datë 23.12.20210, për të cilën të paditurit kanë marr shpërblimin/kompensimin nga shpronësimi në shumë prej 11,925.00€, me çka janë pasuruar pabazë, si dhe të detyrohen të paditurit që paditësit t'ia paguajnë shumën prej 11,925.00€ në mënyrë solidare me kamatë prej 7% duke llogaritur nga data 07.12.2011 së bashku me shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,163.20 €.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor paditësit , kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni, të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancës dhe ta aprovoi kërkesëpadinë e paditësve .

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësit, është i pathemeltë.

Nga shkresat e çështjes rezulton së paditësi kundër të paditurve ka ushtruar padi për pasurim të pabazë. Pretendimet si në padi paditësi i mbështet në rrethanat se ai ishte pronar faktik, mbi 50 vite, mbi bazën e mbajtjes në posedim me mirëbesim të paluajtshmërisë që evidentohet si parcela kadastrale numër P-....., me sipërfaqe prej 250 m2, të vendi i quajtur V./V. në S.. Theksojnë se të paditurit duke shfrytëzuar faktin se ishin formalisht të evidentuar si pronar juridik të pronës kontestuese kanë marrë kompensimin, në emër të shpronësimit, të pronës numër ... në shumë prej

11,925.20€ dhe kështu ata kanë privuar kundërligjshëm paditësin nga përfitimi i të hollave që do të realizonte pas shpronësimit të paluajtshmërisë, që ai mbante në posedim mbi 50 vite, me çka të paditurit janë pasuruar pabazë në dëm të paditësit, andaj nisur nga kjo situatë ata kërkojnë që të detyrohen të paditurit t'ua kthejnë shumën e marrë si shpërblim nga shpronësimi i pronës në fjalë duke qenë se paditësi ishte pronar faktik i kësaj prone, mbi 50 vite.

Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e shpallur paditësin "pronar faktit" dhe se ka qenë ish pronar i pronës numër ... që tashmë është shpronësuar nga qeveria e Republikës së Kosovës për nevoja të ndërtimit të rrugës V.- M., si dhe ka detyruar të paditurit që paditësit t'ia kthejnë shumën prej 11,925.20 € në emër të pasurimit të pabazë.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore.

Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka ardhur deri te zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast kjo gjykatë vlerëson se ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, andaj si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materialeka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 par. 1 pika e), e lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, pasi që siç u cek më lartë ka gjetur se nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, por sipas kësaj gjendje të vërtetuar gabimisht është zbatuar e drejta materiale.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar ka gjetur se vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë, për bazueshmërinë e kërkesëpadiës së paditësit, se të paditurit në mënyrë të kundërligjshme i kanë cenuar paditësit të drejtat pronësore dhe pasurore, nuk gjen mbështetje nga themeli faktik që buron nga tërësia e fakteve dhe provave të çështjes. Më tej kjo gjykatë vlerëson se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, edhe pas rikthimit të çështjes në

rigjykim, përkundër rekomandimeve dhe sugjerimeve të dhëna nga gjykata e Apelit, për t'u vërtetuar rrethana të qarta faktike e ligjore, ajo duke dhënë vlerësime të gabueshme karshi tërësisë së fakteve dhe provave që përmban themeli faktik i çështjes ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale respektivisht në mungesë të themelësisë faktike, në mënyrë kontradiktore, duke mos zbatuar fare dispozita konkrete materiale mbi gjendjen faktike të vërtetuar ka ardhur deri tek përfundimi i gabuar për themelësinë ligjore të kërkesëpadisë së paditësit.

Pretendimet ankimore të paditurve për (pa)themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit janë tërësisht të themelta sepse paditësi në asnjë mënyrë nuk ka arritur të paraqes minimumin e kërkesave ligjore të cilat kërkohen që të vërtetohen në dritën e rrethanave të pretenduara përkitazi me të drejtat pronësore të paditësit mbi paluajtshmërinë objekt shqyrtimi. Në radhë të parë paditësit nuk kanë arritur të faktojnë e aq më pak të provojnë me dëshmi të vlefshme rrethanat se ata mund të kishin qenë pronar të pronës numër para shpronësimit respektivisht se ata mbanin titullin e zotëruesit të interesit, në këtë rast, para shpronësimit. Pretendimet se ata kishin pronën në posedim mbi 50 vjeçar nuk u arritën të vërtetohen me prova me relevancë dhe se dëshmitë e dëshmitarëve nuk mund të konsiderohen prova të vlefshme për. të argumentuar plotësimin e kërkesave të ligjit për njohjen e pronësisë së paditësit mbi pronën e të paditurve, para shpronësimit.

Gjykata e Apelit me Aktvendimin AC.nr. 1672/13 date 12.03.2018 i kishte dhënë rekomandime të qarta gjykatës së shkallës së parë, por edhe ndërgjyësve për orientimin e zgjidhjes së drejtë të çështjes dhe në këtë kontekst ajo ka sugjeruar sqarimin dhe vërtetimin e pretendimeve përkitazi me atë nëse paditësi si pronar faktik i kishte plotësuar kushtet ligjore për t'u konsideruar edhe pronar juridik?!.. si parakusht për të vërtetuar pretendimet për kthimin shumës prej 11,925.20 € si pasurim i pabazë i të paditurve.

Gjykata e shkallës së parë përkundër pamjaftueshmërisë së të provuarit të këtyre pretendimeve ka mbivlerësuar rrethanat faktike në favor të paditësit duke devijuar edhe nga vet rregullsia e mënyrës së vendosjes kur shpall "pronar faktik" paditësin mbi pronën që tani të paditurit nuk mbajnë më asnjë titull pronësorë, dhe duke mbështetur këtë epilog në arsyetime që janë në kontradiktë të hapur me faktet dhe provat- provuarit të cilat nuk arrijnë të prezantojnë minimalisht themelin faktik të pretendimeve nga padia e paditësit, ndaj dhe për këtë është dashur që çështja të përliqjet duke gjetur se paditësi në mungesë të provuarit të ekzistimit të themelit faktik të pretendimeve të ngritura nuk ka arritur të formësojë ndonjë situatë që përkon me dispozita positive që mundësojnë paditësit njohjen e të drejtave të pretenduara mbi pronën objekt shqyrtimi, kjo në raport me të paditurit si pronar me titull.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit për shkelje të dispozitave të LPK-së (të cilat nuk janë të specifikuara fare në revizion) dhe shkelje të së drejtës materiale, nuk mund t'i vënë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditësit, pasi që janë dhënë arsye ligjore bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo gjykatë. Edhe Gjykata Supreme e Kosovës gjene se nga provat e zhvilluara, në shkresa e lëndës paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të dëshmojë as posedimin e pa penguar dhe faktin se prona evidentohet në emër të paditurve mbi bazën e trashëgimisë nga i ati i tyre R. B.. Këtë ngastër i njëjti e kishte fituar me kontratën e ndarjes së bashkësisë familjare VR.nr..... të datës 30.09.1985. Ndërsa sipas evidencës së tanishme kadastrale prona evidentohet në emër të pasardhësve të R. B..

Prandaj edhe pretendimi eventual i revizionit për rrezikshmërinë e kontratës në vështrim dispozitave të LMD-së është i paqëndrueshëm sepse nuk janë shfrytëzuar mjetet ligjore, për të kundërshtuar punën juridike nëse është e konsideruar si jo e ligjshme sipas paditësve, sepse sipas nenit 117 të LMD-së, parashihet se *"E drejta për të kërkuar anulimin e rrëzueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga data kur të jetë ditur shkaku i rrëzueshmërisë, .."*. Kjo e drejtë në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej 5 vitesh, nga data e lidhjes së kontratës, ndërsa në rastin konkret, ndarja fizike është bërë me kontratën VR.nr..... të datës 30.09.1985, gjë që i bie që ka kaluar afati për të kërkuar rrëzueshmëri As kontratën e ndarjes së pasurisë familjare e as vendimin e trashëgimisë paditësit apo paraardhësi i tyre nuk e kishin atakuar në kohë të paraparë me ligj.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se paditësi nuk arriti të dëshmoi se e ka fituar pronësinë në paluajtshmërinë e më lartë theksuar, në bazë të ligjit përkatësisht në bazë të institutit të së drejtës civile-parashkrimit fitues-mbajtjes, pra, në mbështetje të dispozitave ligjore të nenit 20 respektivisht nenit 28.4 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike (Gaz.Zyrtare e RSFJ nr. 6/80, 36/90) i zbatueshëm në atë kohë i cili parasheh se, *"E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj"*- që nënkupton formën me shkrim, vërtetimin e autoritetit dhe regjistrimin e pronës në regjistra publik. Për bartjen e pronësisë në

paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet atij që e tjetëron dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri.

Për fitimin e të drejtës së pronësisë me parashkrimin fitues-mbajtjes, kërkohet posedimi me mirëbesim. Poseduesi me mirëbesim mbi sendin e paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtë pronësie, e fiton të drejtën e pronësisë në atë send me posedim me kalimin e kohës prej 20 vjet (neni 28 paragrafi 3 dhe 4). Poseduesi me mirëbesim është ai i cili me arsye beson se është pronar. Në rastin konkret prona edhe tani evidentohet në emër të paditurve, paditësi ka deklaruar se patundshmërinë kontestuese e shfrytëzojnë prej vitit 19601, edhe pse është regjistruar si pronë e të paditurve, mirëpo edhe sikur të ishte plotësuar kushti kohor, nuk e ka pasur në posedim me mirëbesim i cili në rastin konkret është fakt kyç për vendimmarrje të drejtë sipas kërkesëpadiës së paditësit. Në dispozitën e nenit 28 paragrafi 2 të Ligjit të lartë përmendur, për fitimin e pronësisë në patundshmëri parashihet plotësimi kumulativ i dy kushteve ligjore, që mbajtësi të jetë me mirëbesim dhe posedimi të jetë i ligjshëm, ndërsa sipas paragrafit 4 të këtij neni kërkohet që mbajtësi të jetë me mirëbesim, që do të thotë se në dy paragrafët kërkohet që gjithsesi mbajtësi të jetë me mirëbesim, që në rastin konkret me vet faktin se paditësi e ka ditur se prona është e regjistruar në emër të paditurës, rezulton se mbajtja e pronës nga paditësi nuk mund të konsiderohet se është me mirëbesim.

Gjykata Supreme e aprovon qëndrimin se dëshmitarët nuk kanë arritur të ofrojnë ose provojnë mjaftueshëm rrethanat, duke mos e pohuar faktin se kanë pas njohuri direkte se kujt i ka takuar dhe kush e ka pasur në posedim pronën kontestuese.

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të pathemelta thëniet e revizionit që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vlerësuar dhe zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit për vërtetimin e pronësisë e mbajtjes në posedim është e pabazuar, se me provat e administruara nuk janë vërtetuar bindshëm faktet me të cilat do të vërtetohej baza e kërkesëpadiës, nga se në këtë kontekst paditësi nuk ka ofruar prova relevante me të cilat do të vërtetonte bazën e kërkesëpadiës, kjo edhe për faktin se në bazë të nenit 322 të LPK-së, barra e të provuarit i takon paditësit. Gjykata drejtë ka vlerësuar se me provat e prezantuara nga paditësi dhe të administruara nga gjykata e shkallës së parë nuk janë vërtetuar bindshëm faktet përkitazi me bazueshmërinë e kërkesëpadiës.

Në revizion, përsëriten thëniet përkitazi me gjendjen faktike, të cilat gjykatat e instancës më të ulët, i kanë vlerësuar dhe për të gjitha këto kanë dhënë arsye në arsyetimin e aktgjykimit. Për më tepër kjo gjykatë shton, se sipas nenit 214.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, përderisa revizioni në të vërtetë, për këtë arsye i godet aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët duke potencuar

se këto aktgjykime janë të bazuara në vlerësimin e gabueshëm të cilat sipas gjykatës së revizionit janë sqaruar në procedurën e shkallës së parë dhe në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës.

Për arsyet e sipërpërmendura revizioni i paditësit u refuzua si i pa themeltë, andaj, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.84/2024, datë 04.03.2024

Kryetari i Kolegjit

Beshir Islami